



Lajmëtari i Radio Marisë

Shtator 2011

Viti III, Nr. 9

Në këtë numër
do të lexoni

Editoriali	1
Fjala e Imzot Masafrës në Festën e Nënë Terezës	2
I Lumi Papa Gjon Pali II dhe Virgjëra Mari (pj. 4)	3
Përshëndetja e Presiden- tit të RM Botërore	4

**Lajmëtari i Radio Marisë
është organ i
Shoqatës Radio Maria.**

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4

Fushë Kërçik

Babrru, Paskuqan

Tiranë, Shqipëri

+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II

Shkodër, Shqipëri

+355 22 24 08 52

E-mail

info@alb.radiomaria.org

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

Radio Maria,

**Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,
mund të dëgjohet në:**

Urshen e rrethina

FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat

FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin

FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras

FM 89.6 MHz;

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,

Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

www.radiomaria.al

DËGJUESIT E RADIO MARISË SHQIPTARE, MISIONARË NË DITËN E NËNË TEREZËS

Të dashur miq,

Më 5 shtator 2011 organizuam një festë të denjë për Nënë Terezën. Ju falënderoj që me praninë tuaj i dhatë dinjitet të krenues dhe e gëzuat Imzot Angjelo Masafrën, Arqipeshkvin metropolit Shkodër-Pult, që kremtoi Meshën e shenjtë në nder të Nënë Terezës, Pajtores së Kapelës së Radio Marisë në Shkodër. Bashkë me të ishin meshtarët bashkëkremtues, Don Ernest Troshani, Don Gjergj Simoni, Atë Artan Seli, Don Sharbeli, Don Gjovalin Simoni dhe Don Arturi.

Ju që ishit në Shkodër të pranishëm në katedrale, së bashku me të gjithë dëgjuesit e Radio Marisë, me dhuratën tuaj për përhapjen e fjalës së Zotit përmes Radio Marisë në Afrikë, u bëtë dëshmitarë dhe dëshminë tuaj e mori dhe e vlerësoi lart Presidenti i Familjes Botërore të Radio Marisë, Z. Emanuele Ferrario. Kështu paraqitët dashurinë e madhe që keni në zemrat tuaja për Të Lumen Nënë Tereza, duke marrë pjesë konkretisht në virtytet që Hyji na i dhuroi përmes saj. Ju takon mirënjohja dhe falënderimi për gjestin e dashurisë që treguat për përhapjen e Ungjillit, tashmë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Afrikë përmes valëve të Radio Marisë.

Falënderoj secilin prej jush që me dhuratën tuaj konkrete u bëtë misionarë, d.m.th. njerëz që janë në shërbim të përhapjes së Fjalës dhe të Dashurisë së Hyjit në botë. Në këtë mënyrë treguam se dëshirojmë që t'u shërbejmë së bashku njerëzve të sëmurë, të vetmuarve, njerëzve për të cilët nuk kujdeset

askush, të cilët shoqëria bashkëkohore i ka braktisur dhe i ka lënë pas dore. Këtë shërbim e kryen vazhdimisht dashuria konkrete që po tregoni duke mbështetur Radio Marinë dhe duke e përhapur Lajmin e gëzueshëm në botë.

Kemi filluar diçka të re që nuk e kemi bërë deri tani, sepse nuk kemi ditur ta bëjmë. Kemi filluar të mendojmë që t'u ndihmojmë edhe të tjerëve, gjë që tregon se tashmë u bëmë besimtarë të pjekur për të cilët ka nevojë Kisha e shenjtë. Këtë pjekuri, për vite me radhë, nuk po e paraqitni me fjalë, sepse ju dëgjojt duke thënë: «dimë shumë pak të flasim», por me vepra, të cilat i pëlqejnë Hyjit. Jemi të ftuar që të rritemi më shumë në virtyte për çdo ditë. Të tillë i do Zoja e Bekuar, Nëna e Këshillit të Mirë, bijtë dhe

bijat e veta. Me rastin e festës së Nënë Terezës, ju treguat se jeni bij të mirë të Nënës së Këshillit të Mirë, që dinë ta mishërojnë mësimin e saj dhe shembullin e madh që na dha Nënë Tereza.

Jam i bindur se Nënë Tereza me ndërmjetësimin e saj do të na nxjerrë

hire të jashtëzakonshme prej Hyjit, që të dimë me dritën e Shpirtit Shenjt t'i zbulojmë detyrat që na i jep Zoti dhe t'i zbatojmë ato sipas frymëzimit dhe forcës të cilën, me anë të lutjes së përditshme, po e përforcon në secilin prej nesh. Zoja e Këshillit të Mirë, Nënë Tereza dhe Shërbëtorët e Hyjit, Pajtorët e Radio Marisë, na bëfshin dritë që shndrit mbi pishtar duke i shndritur të gjithë. Ndërmjetësimi i tyre na bashkoi në dashuri dhe na forcoi që të udhëtojmë së bashku.

Don Preka



FJALA E IMZOT MASAFRËS NË MESHËN E FESTËS SË NËNË TEREZËS

Për shumë vjet festën e Nënë Terezës të gjithë juve që jeni në Katedrale, juve që na ndiqni nëpërmjet Radio Marisë edhe nëpërmjet ekranit të TV Rozafës.

Kujtimi liturgjik që bën Kisha sot, më 5 shtator, për Nënë Terezën është gjithmonë një rast shumë i volitshëm për të medituar mbi jetën dhe përshpirtërinë e saj, që në fund të fundit është zbatimi i Ungjillit. Çdo i lumë apo i shenjtë është shpallur i tillë pikërisht sepse ka zbatuar Ungjillin, sepse vetëm Krishti është i përsosur, është vetë Ungjilli. Por, shenjtërit dallohen për zbatimin e një pjese të mësimin të Ungjillit. Nënë Tereza, si shumë shenjtër të tjerë, dallohet për dashurinë që ka pasur ndaj Hyjit të kryqëzuar dhe për mëshirën që vetë ajo e ka provuar nga ana e Hyjit dhe dëshirën për të qenë në zemrën e njerëzve më të braktisur, më të padëshiruar, te më të varfrit ndër të varfër. Kështu ajo zbotoi ato fjalë të kapitullit 25 të Ungjillit sipas Mateut ku Jezusi thotë: 'Për të vërtetë po ju them: çkado bëtë për njërin ndër këta vëllezërit e mi më të vegjël, e bëtë për mua'. Pra, mund të themi se Hyji hyn në zemrën e njeriut dhe vuan kur njeriu vuan. Jezusi vërtet vdiq e u ringjall, por Ai vuan edhe sot kur njeriu vuan nga uria, kur njerëzit nuk kanë bukë; vuan edhe sot kur njeriu nuk ka shtëpi, kur është në luftë; e po kështu gëzon kur njeriu ndihmon. Atëherë, ne do t'ia drejtojmë këtë lutje sot Nënë Terezës: "Ti je shpallur e lume, sepse ke zbatuar një pjesë të lumturive që kemi dëgjuar sot nga Ungjilli sipas Mateut. Lum të mëshirshmit, sepse do të gjejnë mëshirë, lum skamnorët ne shpirt, sepse e tyre është mbretëria e qiejve. Bëj o Nënë Tereza që ne të dashurohemi me Krishtin dhe t'i përjetojmë këto lumturi".

Ne shqiptarët rrezikojmë një gjë në veçanti. Vjet kemi përjetuar 100-vjetorin e lindjes së Nënë Terezës. Bëmë shumë veprimtari kulturore, sociale, etj. Kemi aeroportin Nënë Tereza, spitalin Nënë Tereza. Sa komuna angazhohen për të pasur një statujë të saj. A nuk na kanoset kështu rreziku që të kënaqemi vetëm me ndërtimin e monumenteve e pastaj nuk bëjmë asgjë si ka dashur Nënë Tereza? Rrugëve kam parë edhe disa dyqane me emrin e saj. Nuk është e drejtë dhe nuk lejohet që të përdoret emri i Nënë Terezës pa lejen e Motrave të saj. Mund t'i kemi këto gjëra të jashtme, por shpirti ynë a angazhohet që të jetë si shpirti i Nënë Terezës? Me këto fjalë iu drejtohem atyre që i kanë bërë këto veprime dhe shtetit. Nuk mjaftojnë monumentet kur nuk punohet si duhet ndaj më të varfërve. Atëherë vetëm krenohemi kot dhe iu hedhim hi syve gjoja se jemi me Nënë Terezën. Jo. Nënë Tereza ka qenë ajo që është angazhuar personalisht me gjithë motrat dhe vëllezërit e saj deri në fund të jetës së saj pranë më të varfërve, të braktisurve e të padëshiruave. Edhe sot, sa e sa njerëz janë të braktisur. Ndoshta edhe disa prej jush që më dëgjoni, ndiheni të braktisur nga dikush. Të themi nga shteti, nga bashkia, nga komuna, nga institucionet shtetërore, ndoshta edhe nga kisha, nga famullitë ose nga familjarët. Atëherë, nëse ne e duam Zotin dhe Nënë Terezën, dhe jemi krenarë që kemi një nënë shqiptare të lume e që quhet nënë e botës, duhet ta kemi këtë përshpirtëri e të jemi më afër atyre që janë të braktisur e të mos i braktisim më. Nuk është e lejueshme, nuk është e drejtë që të gjithë fëmijët të largohen jashtë shtetit e këtu të mbeten pleqtë. E kam bërë disa herë këtë thirrje në vizitat e mia baritore. Është gabim kundër urdhrit të katërt të Zotit. Nënë Tereza i është drejtuar një kombi disa herë me këto fjalë. Përsa i përket fëmijëve të padëshiruar që vriten përmes abortit, ajo ka thënë gjithmonë që fëmijët të lindin e t'ia çojnë asaj, nëse prindërit nuk i duan, sepse i ushqen e i rrit ajo me motrat e veta. E ne shqiptarët çfarë bëjmë? Edhe ne jemi duke u plakur. Ajo çfarë është duke u ndodhur kombeve evropiano-perëndimore, po na ndodh edhe neve. Të gjithë, shumica e fëmijëve që martohej, dalin jashtë. Para 20 vjetësh, ne kemi qenë kombi më i ri në Evropë. Pas 20 vjetësh, do të bëhemi kombi më i vjetër në Evropë. Sot për sot, jam profet i rrejshëm që gabo, por në këtë mënyrë do të mbarojmë edhe ne. Sa fshatra kanë ngelur vetëm me pleq në jug të Italisë. Ka fshatra në Kalabri që kanë mbetur vetëm me 4 shtëpi. Kështu do të ndodhë dhe në fshatrat tona, nëse nuk lind dëshira për ta dashur vendin tonë, për ta dashur jetën.

Festa e Nënë Terezës është edhe festa e jetës. Ajo e kushtoi krejt jetën e saj në mbrojtje të jetës, edhe të jetës tonë. Ne të gjithë jemi të thirrur për shenjtërim në saje të pagëzimit. Zoti dhe Kisha, përmes ruajtjes së besnikërisë së premtimeve të pagëzimit, na bëjnë thirrje për të qenë të shenjtë. E për të qenë të shenjtë nuk nevojitet të bëjmë gjëra të mëdha si ato që i keni përjetuar në kohën e komunizmit, ku njerëzit u vranë për të ruajtur fenë. Këto kanë qenë gjëra të mëdha, vepra të mëdha për të ruajtur fenë me rrezikun e jetës, për mbajtjen e një rruzareje në shtëpi, një libër uratësh për t'ua mësuar lutjet fëmijëve, etj. Ato kanë qenë gjëra të mëdha. Sot duhet që gjërat e vogla t'i bëjmë me dashuri të madhe. Ky është sekret i ose ilaçi për ta rritur shenjtërinë tonë, të bëjmë gjëra të përditshme. A keni qenë dje në Meshë? Apo jo? Shpresoj që po. A keni dëgjuar? A jua kanë komentuar meshtarët leximin e dytë ku Shën Pali u thotë romakëve se ne kemi një detyrim, ne e kemi borxh ta duam tjetrin, ashtu si Hyji na ka dashur neve. Duajeni njëri-tjetrin sikurse unë ju desha juve - thotë Jezusi. E dashuria ndaj tjetrit tregohet me vepra besnikërie ndaj urdhërimeve të Hyjit. Një pjesë i përket Hyjit e pjesa tjetër, më e madhja (4-10), i përket marrëdhënieve ndaj të tjerëve. Se vetëm kështu ne mund të jemi të lumtur, duke bërë të mirën, duke zbatuar urdhërimet e Hyjit, duke u përpjekur sa më shumë për ta dashur tjetrin, duke qenë besnikë - të martuarit në jetën martesore, e po njësoj të shuguruarit në jetën e shuguruar, duke qenë besnikë në punë, duke e respektuar jetën, duke e respektuar tjetrin, duke mos qenë peng i lakmive, etj. Kështu, duke bërë këto gjëra të vogla me një përshpirtëri e dashuri të madhe, atëherë mund të ecim drejt shenjtërimit. Jezusi tha: "Unë erdha jo për të qenë shërbyer, por për të shërbyer". Sa do të dëshiroja që të gjithë ne të ishim në shërbim ndaj tjetrit. Veçse duhet të luftojmë krenarinë, mendjemadhësinë dhe tundimin që të gjithë jemi gjithçka, tundim që mund ta kemi edhe ne si meshtarë, si ipeshkvij e çdo njeri.

Jeta është në shërbim të tjetrit. Dhe Papa Benedikti XVI në Madrid ka këmbëngulur shumë herë në këtë drejtim në bisedat e tij me të rinjtë. Këtu kemi një rrezik, pasi jo çdo detyrë civile apo fetare shihet si shërbim, por si pushtet për ta sunduar tjetrin, për të bërë para, me ose pa të drejtë. Atëherë, është e kotë që jemi krenarë për Nënë Terezën, nëse të gjithë nuk përkulemi para Zotit e para saj për ta thithur nga Eukaristia përshpirtërinë për të qenë më të drejtë, më të mirë, për t'u angazhuar sa më shumë për lehtësimin e vuajtjeve të të tjerëve. Dje në Katedrale, thashë se ne mbetemi gjithmonë fëmijë. Kur kemi nevojë, dëshirojmë që të gjithë të interesohen për ne. Kur kanë nevojë të tjerët, të gjithë largohemi nga rreziku, nga çdo punë. Ky është rreziku që kemi ne. Atëherë të mësojmë nga Nënë Tereza përshpirtërinë e dashurisë, shërbimit, drejtësisë dhe të mirës. Le të jemi ata që u fshijnë lotët atyre që kanë turp të qajnë ose që janë të dobët e qajnë nën çarçafë. Jo vetëm Zoti, por edhe ne duhet të jemi ata që i ndihmojnë të tjerët për t'ua fshirë lotët kur janë në nevojë. Dhe të mos harrojmë që në fundin e jetës sonë, si na kujton Shën Tereza e Avilës, do të gjykohej nga veprat e dashurisë, veprat e bamirësisë. Forcën që ka pasur Nënë Tereza për të bërë gjithçka, e ka marrë nga Eukaristia, nga lutja. Eukaristia është buka e jetës. Eukaristia është si motori që na nxit të angazhohemi dhe t'i rrisim virtytet qytetare. Pa bukë nuk jetohej, e pa Eukaristi nuk mund të jemi të mirë e as të shenjtë. Qoftë lëvdur Jezu Krishti!

+Imzot Anjelo Masafra

I LUMI PAPA GJON PALI II DHE VIRGJËRA MARI

Ky është një shkrim i punuar nga Imzot Juan Miguel Ferrer Grenesche, Nënsekretar i kongregatës për kultin Hyjnor dhe disiplinën e sakramenteve, të cilin do ta sjellim me pjesë në disa numra të Lajmëtarit.

...vazhdon nga numri i kaluar

Në pikën nr. 43, në fundin e Letrës, Pap në mënyrë të veçantë i ftoi të rinjtë duke thënë: «Një lutje kaq e lehtë, por në të njëjtën kohë kaq e pasur, meriton më të vërtetë që të rizbulohet nga bashkësia e krishterë... Që kjo ftesë e imja mos të mbetet e padëgjuar!...» Dhe duke cituar Të Lumin Bartolo Longo, apostullin e Ruzares, përfundoi: «Ti do të jesh ngushëllim në çastet e fundit të jetës. Ty të qoftë puthja e fundit e jetës që fikët. Fjala e fundit e buzëve tona do të jetë emri yt i ëmbël, o Mbretëreshë e Ruzares së Pompeit, o nënë e jona e dashur, streha e mëkatarëve, ngushëlluese sovranë e të varfërve. Ji gjithkund e bekuar, sot e përgjithmonë, në tokë e në qiell». Nëse këto reflektime kanë mundësi të përmbledhin linjat themelore të përshtetërisë mariane të Gjonit Palit II, tani do të themi diçka rreth mariologjisë, nga një perspektivë teologjike.

Gjoni Pali II, Magjisteri i tij Marian, linjat teologjike

Studimet e ndryshme për Mariologjinë e Gjonit Palit II kanë treguar se ajo themelohej thelbësisht në doktrinën tradicionale e Kishës më theks të rijetësimeve të Kushtetutës “*Lumen Gentium*” të Koncilit II Vatikanas të mësimave mariane të Papës Palit VI. Nga ana tjetër, linja më e zhvilluar e Papës për Marinë ka qenë ajo e ndërmjetësimit të Marisë, ose «ndërmjetësimit amnor», siç e kishte zakon ta quante Gjoni Pali II. Kështu aspekti mariologjik dhe baritor që përqendruar në praninë aktuale dhe për veprimin efikas të Virgjërës në Kishë dhe në botë. Në këtë kuptim, ia lejoj vetës që të dalloj dy aplikime të rëndësishme të mariologjisë së Gjonit Palit II që janë relative në dy realitete themelore për të ardhmen e njerëzimit që reflektohen në dokumentet që u publikuan gjatë magjisterit të tij:

a) Identiteti dhe thirrja e gruas në botë, të cilës Ati i shenjtë ia kushtoi Letrën apostolike “*Mulieris dignitatem*” (15 gusht 1988), që u publikua me rastin e Vitit Marian. Një feminizëm që nuk e meriton këtë emër dhe që duket se dëshiron të mohojë vetë bazën e dinjitetit të gruas dhe një ideologji të këtij lloji që pretendon për të vërtetuar lirinë e qenies njerëzore, duke mohuar vetë natyrshmërinë, duke bërë secilën ditë më të ndritshme dhe duke bërë më në përputhje kontributin doktrinor dhe kulturor të kësaj Letre të Papës për Marinë.

b) Vlera e jetës dhe rëndësia e mbrojtjes së saj efikase dhe aktuale. Gjoni Pali II ia kushtoi letrën e vet enciklike “*Evangelium Vitae*” (25 mars 1995; sidomos pikat nr. 102-105) për këtë vlerë. Një doktrinë e theksuar shumë («në shenjen e Virgjërës Nënë») që i ofrohet botës aktuale, sië kujtoi edhe Papa Benedikti XVI në fillimin e këtij viti liturgjik, duke thirrur një vigjilje të lutjes botërore në nderim të jetës që lind, në të cilën soditja e mistereve të lumturisë së Ruzares zuri një vend të rëndësishëm, përmes rileximit të këtyre teksteve mariane që janë pjesë e enciklikës së Pararendësit të tij.

Edhe një herë, nga linjat teologjike shihet se bindje shpirtërore të Gjonit Palit II e sollën për të nderuar edhe përshtetërinë e tij, teologjinë, krejt jetën e tij dhe mbarështimin drejt qenies njerëzore, të dashur nga Hyji, dhe kështu që ka nevojë për shëlbim. Sikurse një nën që nuk lodhe duke u kujdesur për fëmijën e saj që është në nevojë ose i humbur.

Gjoni Pali II, një pontifikat i rëndësishëm pas Koncilit II Vatikanas, linjat mariane

Qoftë sinodi i jashtëzakonshëm i vitit 1985, qoftë kremtimi i Jubileut të Mashë në vitin 2000 kanë treguar se linja baritore themelore për pontifikatin e gjatë të Gjonit Palit II ishte interpretimi i drejtë dhe aplikimi i Koncilit II Vatikanas.

Kjo gjë u konkretizua në një varg të veprimeve të mëdha të drejtimit të cilat unë këtu do të mundohem që t'i përmbledh, pa pretenduar që të jap një numërim komplet, na ato që i konsideroj në mënyrë të përgjithshme më të njohurat.

a) «Kodi i Ri i të drejtës kanonike» (25 janar 1983). Sa i përket kodit do të citoj atë gjë që ai vet e citoi dhe e porositi shprehimisht, në kontekstin e kultit marian: Lutja e Ruzares (kan. 246 §3). Në këtë normë, që flet për formimin e meshtarëve të ardhshëm, rekomandohet që të vazhdojmë për tu lutur, sepse vetëm kështu ia dalim që përmes shembullit të bindjes sonë, këtë përshtetëri ta sjellim tek të gjithë besimtarët.

b) «Katekizmi i Kishës Katolike» 1^a botimi 1992; botimi në gjuhën latine në vitin 1997). Katekizmi së bashku me Direktorin e përgjithshëm të katekezës, që një element i rëndësishëm themelore për punën në transmetimin e fesë dhe formimin e krishterë në të gjitha nivelet. Katekizmi përmban pjesët solide që i kushtohen doktrinës mariologjike (pikat nr. 484-511 dhe 963-975) dhe përshtetërisë mariane (pikat nr. 971 dhe 2675-2679), duke na kujtuar në mënyrë të veçantë Ruzaren (pikat nr. 971. 2678 dhe 2708).

c) Në fushën liturgjike, Pap Gjoni Pali II premtoi («thirrjen») sipas asaj që dha në librat liturgjik, pas 25 viteve librat liturgjik pas Koncilit. Përbrenda kësaj përmbledhjeje, duhet përfshi botimin që ka vlerë të madhe liturgjike, teologjike dhe shpirtërore, i «Përmbledhjes së Meshëve të së Lumës Mari Virgjër», përgatitur për kremtimin e Vitit Marian duke menduar në kultin që kremtohet në shenjtëroret mariane në mbarë botën.

Këto tri veprime të mëdha të Gjonit Palit II, së bashku me preket e tija mariane, janë një shembull shumë i mirë i përmasës së personit dhe të mbarështimit të këtij Pape të madh.

Nuk kemi mundësi të përfundojmë këto konsiderata për marrëdhënien e Gjonit Palit II me Të Lumen Mari Virgjër pa përmend aspak mbrojtjen amnore të Marisë në ballafaqimet e tij dhe pranimin që Papa ia rezervoi Marisë.

Vazhdon në numrin vijues...

PËRSHËNDETJA E PRESIDENTIT TË RADIO MARIË BOTËRORE

Në datën 5 shtator 2011, Radio Maria Shqiptare organizoi festën e së lumes Nënë Tereza në Katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër. Ky organizim kishte si qëllim bashkëpunimin për përhapjen e Fjalës së Zotit në mbarë botën, por sidomos në kontinentin e Afrikës. Radio Maria ka bërë në këtë ditë një emision për t'i falënderuar të gjithë ata që u bashkuan për ta ofruar kontributin e tyre në mënyra të ndryshme. Në këtë emision ka kërkuar ndërhyrjen e tij presidenti i Familjes Botërore, z. Emanuele Ferrario, për ta bashkëndarë gëzimin e kësaj dite. Ndër të tjera, ai tha:

- Është një kënaqësi e madhe për mua që në këto çaste të jem në transmetim të drejtpërdrejtë me ju të dashur dëgjues të Radio Marisë në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë sot në festën e të Lumes Nënë Tereza, e cila është një bijë e madhe e popullit tuaj.

Së pari, dëshiroj të kujtoj shkëlqesinë e Tij, Imzot Angjelo Masafrën, Arqipeshkvin Metropolit të Dioqezës Shkodër-Pult, sepse ai është themeluesi i vërtetë i Radio Marisë në Shqipëri dhe e falënderoj për këtë nismë të madhe që ka ndërmarrë para tetë viteve për themelimin e kësaj radioje.

Sot, në mënyrë të veçantë, e shpreh mirënjohjen time për kontributin e dhënë nga ana juaj për përhapjen e Fjalës së Zotit. Dhe jam i sigurt se ky kontribut është si një farë e cila do të japë fryte, sepse brenda kësaj fare që sot ju e keni mbjellë, ka një dashuri të madhe. E kam ndjerë në vetvete këtë ndjenjë tuajën për bashkëndarje dhe njësim. Më besoni se ka shumë vende të pasura që nuk e kanë këtë dashuri. Sapo kam dëgjuar për këtë nismë tuajën, i kam kërkuar drejtorit të Radio Marisë, Don Prekës, që të ndërhyj në këtë emision dhe t'ju them të gjithëve "Faleminderit!". Ky falënderim del prej zemrës sime.

Jam i bindur se Radio Maria do ta ketë një të ardhme të madhe në Shqipëri, sepse është dashuria që zhvillohet dhe shumëzohet.

I falënderoj dëgjuesit dhe të gjithë ata që kontribuojnë për përhapjen e Fjalës së Zotit në vendin tuaj.

Z. Emanuele Ferrario
President i Radio Marisë Botërore



Foto nga Festa e
Nënë Terezës
në datën 5 shtator,
në Katedralen
e Shën Shtjefnit
në Shkodër.



PRO CREDIT BANK
600388970102 (EURO) Nr. LLOGARISË
Kodi SWIFT: FEFAALTR
IBAN: AL452091516090000600388970102
600388970001 (LEK) Nr. LLOGARISË
Kodi SWIFT: FEFAALTR
IBAN: AL 56209516090000600388970001

INTESA SAN PAOLO BANK
1043631803 (EURO) Nr. LLOGARISË
Kodi SWIFT: USALALTR
IBAN: AL 25208110080000001043631803
1043631801 (LEK) LLOGARIA NË
Kodi SWIFT: USALALTR
IBAN: AL 79208110080000001043631801

NË ZVICËR ME 5 FRANGA
Duke telefonuar në numrin:
0900123411
Në bankën CREDIT SUISSE
RADIO MARIA
LLOGARIA NË CHF 380-500-4
IBAN: CH1804835036117310001